

SHTOJCË

Kjo shtojcë nuk bën pjesë në analizën e propozimeve të ECRI-t lidhur me gjendjen në Shqipëri

ECRI vë në dukje se analiza që paraqitet në raportin e tij të tretë për Shqipërinë mban datën 17 dhjetor 2004, dhe se çdo zhvillim që ka ndodhur më pas nuk përfshihet në të.

Në përputhje me procedurën vend për vend që zhvillon ECRI, projekt-raporti i ECRI-t për Shqipërinë ka përbërë objektin e një dialogu konfidencial me autoritetet shqiptare. Disa nga vërejtjet e tyre janë marrë parasysh nga ECRI, i cili i ka përfshirë në këtë raport.

Megjithatë, pas këtij dialogu, autoritetet shqiptare kërkuan që pikëpamjet e tyre të përfshihen në shtojcën e raportit të ECRI-t.

“ KOMENTE DHE OPINIONE PËR DISA ÇËSHTJE TË VEÇANTA TË
PROJEKT - RAPORTIT TË TRETË PËR SHQIPËRINË

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë vlerëson punën e Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në hartimin e Draft Raportit të tretë për Shqipërinë si dhe rekomandimet përkatëse, të cilat pasqyrojnë vëmendjen sistematike të këtij komisioni lidhur me çështjen e pakicave kombëtare që jetojnë në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, vlerësojmë faktin që ECRI konstaton progres në disa fusha, problematika e të cilave është trajtuar në raportin e tij të dytë (Prill 2001).

2. Në Shqipëri, marrëdhëniet e mira, toleranca, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat kombëtare që jetojnë në territorin e saj kanë një traditë historike, e cila mund të shërbejë si model për të gjithë rajonin e Ballkanit.

3. Duke vlerësuar çështjen e respektimit të të drejtave të pakicave, Qeveria Shqiptare është e angazhuar për të ndërmarrë çdo iniciativë që ndihmon në përmirësimin e gjëndjes së tyre, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre kombëtar, kulturor, traditat dhe gjuhën e tyre.

4. Më poshtë po ju paraqesim komentet dhe sugjerimet tona për disa nga çështjet dhe rekomandimet e Projekt-raportit, të cilat mendojme se duhet të rikonsiderohen ose korigjohen.

5. Lidhur me rekomandimin për nënshkrimin dhe ratifikimin e Kartës Evropiane “Për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” (parag.6), mendojmë se duhet të merret në konsideratë qëndrimi ynë zyrtar për mosnënshkrimin e këtij dokumenti, i cili bazohet si më poshtë vijon:

- Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave garantohet më së miri nga legjislacioni aktual i brendshëm, duke filluar që nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe mjaft ligje të tjera. Ashtu si edhe në fusha të tjera ky legjislacion po përmirësohet dhe plotësohet në mënyrë të vazhdueshme.
- Konventa Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, e cila pas ratifikimit konsiderohet pjesë e legjislacionit të brendshëm, vlerësohet si garanci e mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Shqipëri.
- Bazuar në gjëndjen aktuale të administratës shtetërore shqiptare, nënshkrimi i Kartës Evropiane “Për gjuhët minoritare ose rajonale”, do të paraqiste vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e saj nga institucionet qendrore dhe vendore.
- Kërkesa për nënshkrimin e kësaj karte nuk është parashtruar ndonjëherë nga përfaqësues të organizatave të pakicave apo ekspertë që trajtojnë çështjet e të drejtave të pakicave. Për këtë arsye kjo çështje shfaqet në mënyrë artificiale dhe e pabazuar në situatën aktuale.

Legjislacioni brendshëm

6. Vitet e fundit ka patur një numër shumë të vogël procedimesh penale për veprat penale me natyrë raciale (nenet 253, 265 dhe 266 të Kodit Penal). Ky është një tregues pozitiv i mungesës në Shqipëri të qëndrimeve, opinioneve dhe shfaqjeve me natyrë raciale, diskriminuese dhe ksenofobe.

7. Pavarësisht nga ky fakt, në funksion të respektimit të parimeve demokratike të legjislacionit penal shqiptar dhe duke e vlerësuar si element të rëndësishëm në përputhje me standartet e përparuara europiane, përfshirja e "motivit racial" si rrethanë rënduese është parashikuar si një ndër hapat legjislativë, që do të realizohen gjatë vitit 2005.

8. Por duhet të sqarohet se përcaktimi si rrethanë rënduese e motiveve racore nuk mund të zbatohet për të gjitha llojet e krimeve, por vetëm për ato krime që kryhen për arsye racore. Për këtë arsye e konsiderojmë të pasaktë frazën "...for all offences..." të inkluduar në rekomandimin përkatës (parag.12) dhe kërkojmë që kjo frazë të hiqet.

9. Lidhur me rekomandimin për forcimin e kuadrit ligjor me qëllim eliminimin e diskriminimit direkt apo indirekt në fushën civile dhe administrative (parag.20) theksojmë se në dokumentin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Evropian janë parashikuar edhe masat legjislative të mëposhtme:

- Amendimi i ligjeve "Për Policinë e Shtetit" dhe "Kodi i Etikës së Policisë", me qëllim rishikimin e procedurave të ankimit për shkeljet në përgjithësi dhe diskriminim në veçanti në organet e policisë.
- Rishikimi i Ligjit "Për Policinë e Shtetit" në funksion të pjesëmarrjes më të gjerë të personave të pakicave në organet e rendit publik, veçanërisht në ato zona ku ata banojnë në një numër të konsiderueshëm.
- Përcaktimi i kriterëve lidhur me të drejtën për përdorimin e gjuhës amtare të pakicave në emërtimet tradicionale lokale dhe treguesve të tjerë topografikë në zonat ku ato banojnë.
- Miratimi i një rregulloreje nga njësitë e qeverisjes lokale, për rritjen e informimit të pjesëtarëve të pakicave nga ana e organeve të pushtetit vendor për të drejtat që u njihen atyre.
- Përdorimi i gjuhës së pakicave gjatë fushatave elektorale në zonat ku ato banojnë, si dhe shpërndarja e broshurave dhe fletëpalosjeve në gjuhën e tyre

10. Duke marrë në konsideratë opinionet e shprehura në parag.18-20 të Projekt-raportit për nivelin e legjislacionit të brendshëm civil dhe administrativ, gjuhojmë se legjislacioni ynë në këto fusha i përgjigjet qëllimit të eliminimit dhe parandalimit të çdo forme të diskriminimit në të gjithë aspektet e jetës sociale dhe ekonomike si punësimi, arsimit, aksesit në shërbimet publike etj.

11. Për këto arsye mendojmë se në paragrafin 20, fjalia e parë e këtij rekomandimi të ndryshohet si më poshtë:

"ECRI inkurajon autoritetet shqiptare të vazhdojnë fuqizimin e kuadrit ligjor në këtë fushë nëpërmjet një legjislacioni të plotë drejtuar në luftën kundër diskriminimit direkt dhe indirekt në fushat kryesore të jetës..."

Pranimi dhe statusi i shtetasve të huaj

12. Si legjislacioni i brendshëm ashtu edhe praktika e përditëshme konfirmojnë se shtetasit e huaj të ardhur në mënyrë ilegale në Shqipëri nuk penalizohen dhe nuk trajtohen si kriminelë. Kjo tashmë është një situatë e konsoliduar. Për këtë arsye gjykojmë se rekomandimi për këtë çështje (parag.43) është i panevojshëm.

Aksesi ne Arsim

13. Në librat shkollore apo çfarëdo lloj literature tjetër nuk gjen fraza, ngjarje ose elementë të përmbajtjes, të cilat nxisin diskriminimin racial dhe ksenofobik për komunitetet rome dhe egjiptiane apo për minoritetet në përgjithësi. Kjo nuk përbën fenomen në Shqipëri. Për këtë arsye gjykojmë se në Rekomandimin përkatës (parag.59), fraza ".....ensuring textbooks do not promote negative stereotypes about Roma and Egyptians...." duhet të hiqet si e papërshtatshme.

Monitorimi i situatës

14. Lidhur me konstatimin e paragrafit 79 të Projekt-raportit për mospërfshirjen e pyetjes mbi përkatësinë etnike gjatë regjistrimit të popullsisë në vitin 2001 si dhe përse i përket rekomandimit mbi organizmin e një regjistrimi tjetër ku të përfshihet pyetja mbi përkatësinë etnike (parag.81) sqarojmë se :

- a) Ndryshimet politike dhe social - ekonomike që po kalon Shqipëria në këtë periudhë tranzicioni dhe sollën një konceptim dhe këndvështrim të ndryshëm nga e kaluara të shfaqjes së interesave të popullsisë. Koncepti dhe tendenca e lëvizjes së lirë të popullsisë, veçanërisht jashtë vendit për arsye punësimi, krijuan një mentalitet tjetër, i cili për arsye të realizimit të këtyre interesave nuk do të pasqyronte realitetin në pyetësor.
- b) Përcaktimi i origjinës etnike vetëm nëpërmjet vetdeklarimit u vlerësua si formë e papërshtatshme sepse për arsyet e përmendura më lart një pjesë e popullsisë nuk do të shprehte realitetin në vetëdeklarimin individual me qëllim përfitimi në funksion të realizimit të interesave të tyre dhe për këtë arsye do të deformatojë rezultati i këtij procesi.
- c) Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm kjo pyetje duhej të shoqërohej edhe me pyetje të tjera plotësuese si përkatësia fetare apo gjuha e nënës, të cilat kishin vështirësitë e tyre teknike në formulimin e pyetjeve përkatëse. Pra, një proces i tillë ishte i vështirë të realizohej.
- d) Mjaft individë, për të realizuar interesat e tyre shfrytëzuan Zyrat e Gjendjes Civile ku nëpërmjet pagesave informale në favor të punonjësve të veçantë, arrinin lehtësisht të ndryshonin karakteristikat dhe të dhënat individuale, përfshirë edhe ndryshimin e kombësisë. Ky fakt e bënte të vështirë sigurimin e një informacioni real dhe objektiv.
- e) Mbledhjen e këtij informacioni e vështirësonte edhe mungesa e një përkufizimi të qartë ligjor mbi pakicat kombëtare.
- f) Nga pikëpamja formale ligjore, Konventa kuadër "Për mbrojtjen e minoriteteve", nuk përcakton ndonjë detyrim të shprehur për shtetet palë që të ndërmarrin një proces të tillë për identifikimin e përkatësisë etnike të shtetasve.

Të gjitha këto arsye të marra së bashku sollën zhvillimin e një pyetësori që identifikon vetëm shtetësinë.

15. Studimi i INSTAT-it mbi pakicat, i cili vlerëson përqindjen e pakicave në 1.4% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, plotësoi vakumin që ekzistonte prej një periudhe të gjatë kohe mbi të dhënat zyrtare të përbërjes etnike në Shqipëri,. Me këtë studim është plotësuar edhe një nga angazhimet kryesore të Qeverisë Shqiptare në kuadrin e Proçesit të Stabilizim-Asocimit me BE.

Pjesmarrja e minoriteteve në jetën publike dhe institucionet shtetërore

16. Lidhur me rekomandimin për sigurimin e një përfaqësimi efektiv në jetën politike të minoriteteve (parag.95), theksojmë se pjesëmarrja e individëve në organet vendimmarrëse legislative dhe ekzekutive, qendrore dhe lokale është e lire për të gjithë kategoritë e shtetasve, pa asnjë lloj diskriminimi apo kufizimi me karakter etnik, racor, fetar, etj.

17. Interesat politike, ekonomike e sociale të pakicave përgjithësisht mbrohen nga të gjitha partitë politike shqiptare, në të cilat aderojnë një numër i konsiderueshëm individësh, që u përkasin pakicave kombëtare. Gjithashtu, në Shqipëri ushtron veprimtarinë Partia "Bashkimi për të Drejtat e Njeriut", që përfaqëson interesat e pakicave (një parti tjetër e tillë është krijuar kohët e fundit), ku aderojnë individë nga grupe të ndryshme minoritare. Pra në këtë këndvështrimi, grupeve minoritare nuk ju është kufizuar hapësira dhe mundësia e përfaqësimit në organet legislative qendrore ose lokale.

18. Në çdo legjislaturë të Kuvendit shqiptar ka patur gjithmonë një mesatare 5-10 deputetë, që u përkasin pakicave (sidomos atij grek). Në Parlament ka një komision të posaçëm për të drejta e njeriut dhe minoriteteve, i cili drejtohet nga një përfaqësues i minoritetit. Të njejtin fakt shprehim edhe për përfaqësimin e pakicave në organet e qeverisjes vendore.

19. Lidhur me regjistrimin e shtetasve që i përkasin këtyre komuniteteve (parag.94), theksojmë se Ligji nr.9296 datë 21.10.2004 "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore" krijon mjaft lehtësi për regjistrimin e personave që i përkasin këtyre grupeve, për efekt të pjesmarrjes së tyre në zgjedhje.

20. Si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe në praktikën e përditshme nuk ekzistojnë elementë dhe kritere kufizuese ose diskriminuese për pakicat. Por nga ana tjetër duhet të merret në konsideratë edhe fakti që pjesmarrja në organet legislative dhe ekzekutive, qendrore ose lokale, në çfarëdo niveli kërkon detyrimisht plotësimin e disa kritereve që lidhen me nivelin arsimor, intelektual dhe profesional të individit. Njëkohësisht një element tjetër determinant është dëshira dhe vetënxitja e çdo individit për t'u angazhuar në jetën publike. Të gjithë shtetasit shqiptarë që posedojnë këto elementë, pavarësisht nga përkatësia etnike, i kanë mundësitë të hapura dhe të barabarta, pa asnjë lloj diskriminimi.

Statusi i komunitetit egjiptian

21. Lidhur me çështjen e statusit të komunitetit egjiptian, theksojmë se në përcaktimin si pakicë kombëtare të një grupi, përveç kriterit subjektiv, që nënkupton zgjedhjen personale për të qënë pjesë e kësaj pakice, ekzistojnë edhe disa kritere objektive, të parashikuar në aktet ndërkombëtare si:

- ekzistencën në këtë grup të karakteristikave etnike, kulturore, fetare, linguistike të qëndrueshme dhe të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë,

- shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë ose gjuhën e tyre.

22. Historikisht “jevgjit” kanë ardhur në Ballkan (përfshirë edhe Shqipërinë), nga India nëpërmjet Egjiptit dhe ky fakt është e vetmja lidhje e tyre me këtë vend. Ndryshe nga romët që kanë karakteristika etnike dhe kanë gjuhën e tyre, jevgjit janë sedentarë dhe të përhapur në shumë zona të Shqipërisë. Në gjuhën e vendit ata quhen “jevgj” dhe origjina e tyre është e diskutueshme. Ata nuk kanë gjuhë të vetën dhe flasin vetëm gjuhën shqipe. Ata janë integruar plotësisht në shoqërinë shqiptare dhe dallimi i tyre i vetëm nga popullsia tjetër shqiptare është ngjyra e lëkurës.

23. Pretendimi i një grupi njerëzish, që e quan veten “egjiptianë” dhe që kërkon të konsiderohet si grup minoritar ekziston vetëm në Shqipëri. Në asnjë vend tjetër të rajonit të Ballkanit dhe Europës nuk ekziston ky grup minoritar. Nëqoftëse shohim Raportet e ECRI-t për të gjithë shtetet anëtare (raporti i dytë ose i tretë), konstatojmë se janë prezente çështjet rreth “komunitetit rom” ose “komunitetit rom/jevgj” dhe nuk evidentohet ndonjë “komunitet egjiptian”. Nëqoftëse do të ishte real, ky komunitet, i madh ose i vogël do të ekzistonte edhe në shtete të tjera, në radhë të parë fqinjë me Shqipërinë.

24. Për këtë çështje, përmendim edhe një herë faktin e shprehur edhe më parë se Ambasada e Republikës Arabe të Egjiptit në Tiranë ka deklaruar se nuk njeh asnjë pakicë egjiptiane në Shqipëri dhe se ky komunitet që jeton në Shqipëri nuk ka lidhje etnike me popullsinë egjiptiane.

25. Duke u bazuar në të gjitha aktet ndërkombëtare për pakicat kombëtare, si dhe duke konsideruar kriteret objektive dhe subjektive të përcaktuar në to për njohjen e statusit pakicave kombëtare, kriteret të pranuar edhe nga Këshilli i Evropës, gjykojmë se nuk ekzistojnë elementët themelorë që mund të obligojnë shtetin shqiptar, për t’i njohur komunitetit egjiptian e statusin e pakicës kombëtare.

26. Argumentat dhe komentet rreth Projekt-raportit, të paraqitura më lart, pasqyrojnë angazhimin serioz të qeverisë shqiptare në luftën kundër shfaqjeve të racizmit, intolerancës, diskrimimit dhe ksenofobisë. Vlerësimi i këtyre rezultateve mendojmë se duhet të merret në konsideratë në përmirësimet eventuale të projektit gjatë procesit të miratimit final të tij.

27. Duke shprehur vlerësimin tonë për punën e bërë nga ECRI, theksojmë edhe një herë qëndrimin konsekuent të Qeverisë shqiptare në favor të respektimit dhe garantimit të të drejtave të pakicave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të këtij procesi.”

* * *